



Planuar / Dorezuar Primitjen/Pridata Received/Delivery	19.11.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	5552/2021		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova**  
**Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo**

Anr.823/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.823/2021, të datës 21.09.2021 të parashtruar nga me adresë banimi Rr" Xhevat Ajazi", nr.15, Gjilan, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, në mënyrë unanime, me datë 19.11.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.823/2021 e datës 21.09.2021 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Anullohet Vendimi me numër protokolli 092/21 i datës 27.08.2021, i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje".**
- III. Detyrohet Zyra për Burime Njerëzore e Shërbimit Korrektues të Kosovës, që të largoj nga dosja personale e nëpunësit civil masën disiplinore "Vërejtje" nga pika 2 e këtij vendimi.**
- IV. Detyrohet Shërbimi Korrektues i Kosovës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditsh nga data e pranimit të këtij vendimi, të njoftoi me shkrim Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi nëpunës civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përmes postës, me datë 21.09.2021 ka pashtuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 092/21, të datës 27.08.2021 të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.09.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës (me tej SHKK). Ndërsa me datë 08.10.2021, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh rrethanat e funksionimit të KPMSHCK-se, me Vendimin nr.37/2021 të datës 04.11.2021 të Kryesuesit të KPMSHCK-së është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A.823/2021 të datës 21.09.2021 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën A nr. 823/2021, e datës 21.09.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë te datës 08.10.2021, me numër protokolli 4963/2021, Kontratën e Punës së datës 14.06.2018, Përshkrimin e detyrave për ankuesin të datës 20.04.2018, Raportin e Komisionit Hetimor të datës 03.08.2021; Vendimin me numër protokolli 092/21 i datës 27.08.2021, e-mailin e datës 12.11.2021 të R.H për A.B, e-maili i datës 12.11.2021 nga R.H për A.B fq ½, fotografi lidhur me rastin , shkresën e datës 05.07.2021 për Gjykatën Themelore në Prishtinë, Shkresën e datës 04.07.2021 nga ankuesi për Drejtorin e Përgjithshëm të SHKK, Raport disiplinor ref.3.1.10 i datës 04.07.2021, Vendim mbi shqiptimin e masës disiplinore ndaj të burgosurit i datës 09.07.2021, Forma për Raportim të Incidentit e datës 04.07.2021 nga ankuesi për Drejtorin dhe Zv. Drejtorin e Përgjithshëm, Formë për raportim të incidentit i datës 04.07.2021 nga ankuesi Forma 3.1.11, Raport i deklaratës së H.K. i datës 04.07.2021, Raport i deklaratës së E.M i datës 04.07.2021, Raport i deklaratës R.I i datës 04.07.2021, Raport i mjetit të dëmtuar forma 3.1.7 i datës 04.07.2021 deklarate e të burgosurit H.S e datës 04.07.2021, rekomandim i datës 05.07.2021, Aktvendim me numër PP.144/21 i datës 02.07.2021 i GJTHP, Raportin për Përdorim të Forcës i datës 04.07.2021. Fletë intervistimi për te burgosurin e datës 15.07.2021, Fletë intervistimi i i datës 15.07.2021, Fletë intervistimi 19.07.2021, Fletë intrevisimi i Fletë Intervistimin e datë 19.07.2021, Fletë intervistimin e A.Murati date 15.01.2021, Fletë intervistimin Fletë intrevistimi i i datës 15.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe pas analizimit të të gjitha provave të lëndës, konstatoi që ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën e punës " Mbikëqyrës" në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan me periudhë të pacaktuar. Me Autorizimin e Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan me numër protokolli 2584/20 të datës 20.04.2021, ankuesi është autorizuar si Mbikëqyrës i Lartë duke filluar nga data 16.04.2020 dhe se i njëjti sipas konfirmimit nga Njësia e Burimeve Njerëzore të SHKK-së i raporton drejtpërdrejtë Udhëheqësit për Siguri.

Me datë 27.08.2021 Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan bazuar në Raportin Hetimor lidhur me rastin HD-05/01/21-Zjarri të datës 03.08.2021, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejte", për shkak të shkeljes së detyrave të punës nga neni 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik si dhe nenin 4 paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civilë të Kosovës.

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se Vendimi i kundërshtuar më ankesë, është i pa bazuar për shkak cenimit të dispozitave të procedurës disiplinore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke shtuar me tej se Komisioni Hetimor nuk ka ofruar prova konkrete lidhur pretendimet e konstatuara dhe se ai ka ndërmarra të gjitha veprimet e nevojshme në ditën kur ka ndodhur ngjarje.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2021 përkatësisht sipas neni 4 paragrafi 1 të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht se të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil si dhe ligjeve të veçanta nga fushëveprimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për zhvillimin e procedurës disiplinore dhe shqyrtimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua neni 48 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: "Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të neni 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", e mbi këtë bazë ligjore rrjedh se Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "vërejtje", sepse i njëjti nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i tij.

Meqenëse një akt administrativ i nxjerrë nga organi i cili nuk ka pasur kompetencë konsiderohet akt i paligjshëm sipas neni 52 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se shqyrtimi i pretendimeve tjera ankimore në rastin konkret është jo relevant.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.823/2021

**Rushit Kajtazi**

Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj-Demi**

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës
- Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

